



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 306/15 prot.

Tiranë, më 6.3.2026

V E N D I M

Nr. 7, datë 6.3.2026

PËR
PROVIMIN E PRANIMIT TË NDIHMËSVE LIGJOR
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 6.3.2026,

V E N D O S I:

1. Të fillojë procedurat për organizimin e provimit të pranimit për ndihmës ligjor për vitin akademik 2026-2027.
2. Numri i vendeve vakante për pranimin në Programin e Formimit Fillestar për kandidatët për ndihmës ligjor do të jetë 41 (dyzet e një).
3. Periudha e regjistrimit për kandidatët për ndihmës ligjor do të jetë 9 – 30 mars 2026.
4. Provimi i pranimit do të zhvillohet në datën 19 maj 2026.
5. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për ndjekjen e procedurave të organizimit të këtij provimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.